


TOENA 400 lekë



# HIRI

roman nga Flutura Aça

Enora Gjura, një gazetare terreni e një të përditshmeje në Tiranë, njihet rastësisht një pasdite gjatë shërbimit të saj të radhës në Prishtinë, me një piktor shumë të njohur shqiptar, i emigruar në Amerikë në fillim të 90-tave. Një dashuri me “shikimin e parë”, do t’i bëjë të dy personazhet protagonistë të një *love story* plot pasion. Por asnjëri nuk e di deri ku shkon e dukshmja dhe e fshehura e lidhjes së tyre. “Keqkuptimet” do të jenë kinse urat që do ta mbajnë këtë lidhje dhe rrëfimin e autores në harkun e një viti mes ndalesash të shpeshta psikologjike. Personazhet bien në grackën e dëshirave ireale, si pjesë të realitetit të përditshëm që vret me rutinën. Por rutina është më e vogla gjë për një marrëdhënie të brishtë në kushtet e një shoqërie tranzicioni. Çfarë i mban dhe i ndan dy njerëz me tërheqje ndaj njëri-tjetrit? A mjafton ndjenja? Dashuria, shpërfillja, harresa, pasioni i verbër, martesë, përkohshmëria, seksi, largësia, ëndrra, loja me tekstin, nënteksti, interteksti, janë dritat e blerta, shpeshherë të fikura, ku lexuesi duhet të shkelë për të mbërritur në shtresimin e fundmë të filozofisë së autores mbi marrëdhënien më themelore, më delikate dhe më vendimtare mbi dhé, atë burrë-grua.